# Ekonomia Politike Ndërkombëtare

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Departamenti I Shkencave Politike** |
| **Titulli i lëndës:** | **Ekonomia Politike Ndërkombëtare** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Zgjedhore** |
| **Viti i studimeve:** | **Tretë (III-të)** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+2** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | **5** |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | **Prof.Dr. Sejdi Rexhepi** |
| **Detajet kontaktuese:** | **sejdi.rexhepi@uni-pr.edu 045/ 308 809** |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | Lënda Ekonomia Politike Ndërkombëtare si një degë e ekonomisë në kuadër të shkencave shoqërore ka në fokusin e vetë të studimit marrëdhëniet ndërkombëtare në raport me ekonominë politike. Në këtë aspekt studiohet ndërvarësinë ekonomike midis vendeve, lëvizjen e mallrave, shërbimeve dhe pagesave midis një vendi dhe pjesës tjetër të botës. Ekonomia Politike Ndërkombëtare është një fushë e kërkimeve, një lëndë interesimi, fokusi qendror I të cilës janë raportet reciproke në mes të fuqisë së publikut dhe asaj private në alokimin e resurseve të pamjaftueshme ndërkombëtare. |
| **Qëllimet e lëndës:** | 1. Ofrimi i **njohurive** hyrëse, mjaftë të kompletuara, të përmbledhura dhe të azhurnuara lidhur Ekonominë dhe Politikën Ndërkombëtare.<br><br>2. Zhvillimi i **aftësive për të njohur** dhe për të **kuptuar** parimet, konceptet dhe ligjet e funksionimit të ekonomisë dhe politës ndërkombëtare<br><br>3. Zhvillimi i aftësive **për aplikimin praktikë** të kornizës teorike lidhur me ekonomin dhe politikën ndërkombëtare me rastin e interpretimit të ndodhive dhe transaksioneve që reflektojnë në përmasa botërore. |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: |

| | |
|---|---|
| | 1. **Të kuptojnë** se çka është ekonomia ndërkombëtare, pikëpamjet kryesore lidhur me ekonominë ndërkombëtare, politikat e bashkëpunimit ekonomik dhe të tregtisë ndërkombëtare, si dhe proceset e përgjithshme të integrimit që janë të lidhura me qarkullimin e mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe financave ndërkombëtare.<br><br>2. **T'i njohin** pikëpamjet kryesore që kanë të bëjnë me tregtinë ndërkombëtare, këmbimin monetar dhe shoqëritë shumëkombëshe dhe politikat përkatëse që i ndjekin shtetet lidhur me bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar.<br><br>3. **Të identifikoj** proceset e përgjithshme ekonomike ndërkombëtare siç janë format e ndryshme të integrimit ekonomik duke filluar nga zona e lirë tregtare, bashkëpunimi doganor, tregu i përbashkët dhe bashkimi ekonomik si dhe të identifikoj rolin dhe rëndësinë e organizatave ndërkombëtare në këtë proces.<br><br>4. Të jenë në gjendje për **të analizuar** dhe kuptuar ndërvarësinë ekonomike në mes të vendeve, qëndrimin e vendeve ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe lidhur me interpretimin e dukurive dhe proceseve bashkëkohore në politikën ekonomike ndërkombëtare.<br><br>5. Të kenë **aftësi** të mjaftueshme që njohuritë e fituara lidhur me politikat ekonomike ndërkombëtare, kategoritë dhe konceptet e ndryshme të ekonomisë ndërkombëtare si dhe këndvështrimet e ndryshme teorike t'i përdor për të përshkruar dukuritë dhe proceset bashkëkohore që ndodhin dhe reflektohen në Ekonominë dhe Politikën Ndërkombëtare.<br><br>6. Që aftësitë dhe dituritë e fituara të mund **ti përdorin** në mënyrë kreative për të njohur, kuptuar, krahasuar, analizuar dhe për të |

| | |
|---|---|
| | zhvilluar mendimin profesional dhe kritik lidhur me dukuritë e ndryshme në Ekonominë dhe Politikën Ndërkombëtare.<br><br>7. Të kenë **aftësi dhe dije** të mjaftueshme për të hartuar dhe zhvilluar mendime dhe koncepte personal lidhur me forcat kryesore shtytëse të ekonomisë botërore bashkëkohore duke filluar nga interpretimi klasik i faktorëve shtytës të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtare deri te interpretimi bashkëkohor. |

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 13 | 26 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | 1 | 15 | 15 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 1 | 15 | 15 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokfiume, seminare | 1 | 5 | 5 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 1 | 15 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | 2 | 2 | 4 |
| Projektet, prezentimet ,etj. | | | |
| **Totali** | | | 125 |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | ***a).Qasja është e bazuar në pjesëmarrjen aktive të studentëve***<br><br>1. Mësimdhënësi shpjegon objektivat e mësimit studentëve përmes ligjëratave,<br>2. Përmes tabelës, projektorit dhe formave tjera vizuale prezantohen teoritë dhe konceptet kryesore |

| | |
|---|---|
| | 3. Mësimi i kombinuar interaktiv do të përdoret<br>4. Konkludime të përbashkëta do të nxirren përmes diskutimit të pyetjeve dhe çështjeve të ngritura.<br><br>**b). Aktivitetet Grupore**<br>1. Tryeza pune, diskutime grupore, prezantime grupore<br><br>**c). Aktivitetet tjera**<br>1. Kërkime të pavarura nga studentët<br>2. Prezantimi i rezultateve<br>3. Seminare<br><br>**d). Mjetet e punës:**<br>Tekste mësimore, artikuj, harta, tabela, projektori, fletat e punës, materiale të përgatitura nga mësimdhënësi, etj. |
| | |
| **Metodat e vlerësimit:** | Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë të disa kritereve bazë. Studentët do të kenë dy teste provuese me shkrim gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe një test (provimin) përfundimtar. Vlerësimi dhe notimi do të bëhet duke marr parasysh suksesin e treguar në teste dhe provimin final si dhe angazhimin e përgjithshëm.<br>Çdo student ka për obligim që të përgatisë një punim seminarik i cili është pjesë e vlerësimit të përgjithshëm nga kjo lëndë. Tema e seminarit duhet të caktohet në bashkëpunim me mësimdhënësin e në pajtim me planin mësimorë nga lënda.<br><br>Nota do të ndërtohet duke marrë për bazë këto kritere:<br>Vlerësimi i parë: 20%<br>Vlerësimi i dytë: 20%<br>Detyrat e shtëpisë 10%<br>Angazhimi dhe vijimi 10%<br>Provimi final 40%<br>**Total 100%** |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | a). Në gjuhen shqipe: |

| | |
|---|---|
| | 1. Ligjëratat e përgatitura të mësimdhënësit;<br>2. Biznesi Ndërkombëtar, Botimi i dytë, Ilia Kristo, Tiranë, 2004.<br>3. Internationla Relations, Joshua S. Goldstein, Përkthim nga Arian e Teuta Starova, Tiranë, 2003.<br>4. Tregtia Ndërkombëtare, Teoria dhe Politika, Ahmet Mançellari, Tiranë, 2004. Shtëpia botuese Dituria, Tiranë. |
| **Literatura shtesë:** | b). Në gjuhen Angleze:<br>1. International Political Economy, Thomas Oatley, 6th Edition, Routledge Taylor & Fransis Group, New York, 2018.<br>2. Global Political Economy, Fifth Edition, John Ravenhill, Oxford University Press, 2017.<br><br>c). Në gjuhën kroate, serbe:<br>**3.** Uvod u Medjunarodnu Ekonomiju, Grup autorësh, Fakulteti Ekonomik, Beograd, botimi i pestë, 2005<br>**4.** Medjunarodna Ekonomija, Ekonomski Fakultet Zagreb, 2000 |

**Plani i dizejnuar i mësimit:**

| **Java** | **Ligjërata që do të zhvillohet** |
|---|---|
| ***Java e parë:*** | Njoftimi me student, prezantimi i mësimdhënësit, prezantime hyrëse lidhur me lëndën dhe programin mësimor, njoftimi lidhur me metodologjinë e punës, vlerësimit dhe notimit. Prezantimi hyrës i Ekonominë dhe Politikën Ndërkombëtare. |
| ***Java e dytë:*** | ***Hyrje në ekonominë botërore***<br>Hapësira tokësore dhe popullsia, të ardhurat, të ardhurat për kokë të banorit, tregtia ndërkombëtare, bilanci i pagesave, dinamika dhe globalizimi, marrëdhëniet tregtare në ekonomin botërore, konkludimet e përbashkëta. |
| ***Java e tretë***: | ***Karakteristikat kryesore të Ekonomisë Botërore***<br>Ndërvarësia ekonomike, ndërvarësia financiare, transferi ndërkombëtar i teknologjisë, migrimi ndërkombëtar i fuqisë punëtore. |
| ***Java e katërt:*** | ***Evoluimi historik i pikëpamjeve lidhur me ekonomin*** |

| | |
|---|---|
| | ***ndërkombëtare***<br>Pikëpamja Merkantiliste, Neomerkantilizmi, Teoria e avantazheve absolute, Teoria e avantazheve krahasuese. |
| ***Java e pestë:*** | **Tregjet dhe modelet e tregtisë ndërkombëtare**<br>Tregjet, modelet botërore të tregtisë, çmimet dhe tregjet, ekonomitë e planifikuara nga shteti, politika e tregjeve, baraspesha e tregtisë. |
| ***Java e gjashtë*:** | **Vlerësimi i pare** |
| ***Java e shtatë:*** | ***Politikat e strategjive tregtare***<br>Ndërvarësia, Autarkia, Proteksionizmi, Industritë dhe grupet e interesit, Tregtia e paligjshme, Politikat e bashkëpunimi tregtar. |
| ***Java e tetë:*** | ***Politikat e regjimeve tregtare***<br>Regjimet tregtare, Qëndrimi i Organizatës Botërore të Tregtisë ndaj strategjive tregtare, Marrëveshjet dypalëshe rajonale, Kartelet. |
| ***Java e nëntë:*** | ***Marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim tregtar***<br>Zona e lirë tregtare, Unioni doganor, Tregu i përbashkët, Unioni ekonomik, OBT dhe qëndrimi i saj. |
| ***Java e dhjetë:*** | ***Proceset ekonomike bashkëkohore***<br>Integrimi, Teoritë e integrimit, Bashkimi Evropian, Integrimet tjera ekonomike regjionale. |
| ***Java e njëmbedhjetë*:** | **Vlerësimi i dytë** |
| ***Java e dymbëdhjetë*:** | ***Sistemi Monetar Ndërkombëtar***<br>Paraja, Sistemi monetar, shkëmbimi monetar ndërkombëtar, kursi i këmbimit ndërkombëtar, Pse monedhat ngrihen dhe bien. |
| ***Java e trembëdhjetë*:** | ***Financat ndërkombëtare***<br>Roli i Bankës Qendrore, Banka Botërore, Fondi Monetar ndërkombëtar, Llogaria Kombëtare, Borxhi ndërkombëtar, gjendja financiare ndërkombëtare |
| ***Java e katërmbëdhjetë*:** | ***Investimet e huaja dhe korporatat shumëkombëshe***<br>Korporatat shumëkombëshe, Investimet e huaja të drejtpërdrejta, Marrëdhëniet në mes të vendit pritës dhe vendit të prejardhjes së biznesit shumëkombësh, Krijimi i ambientit për investime të huaja të drejtpërdrejta. |
| ***Java e pesëmbëdhjetë*:** | **Vlerësimi përfundimtar** |

| **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:** |
|---|
| Studentët me qëllim të arritjes së suksesit të lartë në studime duhet që:<br>1. Të vijojnë rregullisht ligjëratat dhe ushtrimet e parapara<br>2. Të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjërata përmes pyetjeve, debateve dhe formave tjera të veprimit interaktiv<br>3. Në marrëveshje me mësimdhënësin të punojnë një detyrë shtëpie prej 7-10 faqe |

dhe ta prezantojnë në klasë.

4. Të marrin pjesë në testet e ndërmjetme si dhe në testin përfundimtar
5. Gjatë kohës së mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, testeve apo provimeve kanë për obligim që t'i nënshtrohen kodit të mirësjelljes (mbajtja e qetësisë në mësim, hyrja me kohë në sallë, lëshimi i sallës me pëlqimin e mësimdhënësit, etj).